



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA - SUPREME COURT OF KOSOVO

- **Për:** Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGjK)
- **Nga:** Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme e Republikës së Kosovës (DHPGJS)
- **Datë:** 16 gusht 2022
- **Lënda:** RAPORT NARRATIV PËR PUNËN E DHOMËS SË POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR PERIUdhËN  
1 prill – 30 qershor 2022

**Lëndët në punë**

Në DHPGJS gjatë tremujorit të dytë kanë qenë të angazhuar 14 gjyqtarë në zgjidhjen e lëndëve, 11 prej tyre në shkallën e parë dhe 3 në shkallën e dytë, gjegjësisht në Kolegjin e Apelit.

Gjithsej në dy shkallët gjyqësore në fillim të tremujorit të dytë të vitit janë trashëguar nga tremujori paraprak 15201 lëndë, janë pranuar edhe 442 lëndë të reja, kështu gjatë tremujorit në punë kanë qenë gjithsej 15643 lëndë.

Në shkallën e parë gjyqësore të trashëguara janë 14254 lëndë, të pranuar gjatë tremujorit janë 211 lëndë, kështu gjatë tremujorit të dytë në punë kanë qenë 14465 lëndë të shkallës së parë.

Në shkallën e dytë gjyqësore të trashëguara janë 947 lëndë, të pranuar gjatë tremujorit janë 231 lëndë, kështu gjatë tremujorit të dytë në punë kanë qenë 1178 lëndë të shkallës së dytë.

### **Mesatarja e ngarkesës së gjyqtarëve me lëndë**

Mesatarisht një gjyqtar i shkallës së parë ka qenë i ngarkuar me 1315 lëndë.  
Mesatarisht një gjyqtar i shkallës së dytë ka qenë i ngarkuar me 392.66 lëndë.

### **Lëndët e zgjidhura**

Gjatë tremujorit në dy shkallët gjyqësore gjithsej janë zgjidhur 6911 lëndë.  
Në shkallën e parë gjyqësore janë zgjidhur 542 lëndë.  
Në shkallën e dytë gjyqësore janë zgjidhur 149 lëndë.

### **Mesatarja e zgjidhjes së lëndëve për gjyqtarë**

Mesatarisht një gjyqtar i shkallës së parë ka zgjidhur 62.6 lëndë.  
Mesatarisht një gjyqtar i shkallës së dytë ka zgjidhur 66.66 lëndë.

### **Lëndët e pazgjidhura në fund të tremujorit të dytë**

Gjithsej në dy shkallët gjyqësore në fund të tremujorit kanë mbetur të pazgjidhura 14952 lëndë.  
Në shkallën e parë gjyqësore të pa zgjidhura kanë mbetur 13923 lëndë.  
Në shkallën e dytë gjyqësore të pa zgjidhura kanë mbetur 1029 lëndë.

### **Mesatarja e lëndëve të pa zgjidhura për gjyqtar në fund të tremujorit të dytë**

Mesatarisht për një gjyqtar të shkallës së parë mbeten të pa zgjidhura 1265.72 lëndë.  
Mesatarisht për një gjyqtar të shkallës së dytë mbeten të pa zgjidhura 343 lëndë.

### **Publikimi i vendimeve**

Gjatë tremujorit është vazhduar me publikimin e vendimeve të Gjykatës, kështu që janë publikuar në Web faqe gjithsej 622 vendime të Dhomës. Prej tyre 511 vendime janë të shkallës së parë gjyqësore kurse 111 janë të shkallës së dytë.

### **Identifikimi i problemeve dhe propozimi për zgjidhjen e tyre**

Problem i vazhdueshëm në DHPGJS është numri i pamjaftueshëm i stafit gjyqësor dhe atij administrativ. Duke patër parasysh numrin e madh të lëndëve dhe numrin e stafit aktual është shumë e vështirë dhe e pa mundur të zgjidhen lëndët e grumbulluara në një afat të arsyeshëm. Gjatë tre mujorit gjykata ka mbetur edhe pa dy bashkëpunëtor/e profesional/e ngase një bashkëpunëtor është emëruar gjyqtar në Gjykatën Themelore të Prishtinës dhe një bashkëpunëtorë ka shkuar në pushim të lehonisë. Mungesa e tyre ka ndikuar edhe në punën e gjyqtarëve. Kështu i propozohet KGJK-ës që të ketë në vëmendje zgjidhjen e këtij problemi duke shtuar numrin e stafit gjyqësor dhe atij administrativ në DHPGJS sa më parë që të jetë e mundur.

Si problem këtyre ditëve është paraqitur edhe zhvendosja e gjykatës në objektin e Gjykatës Supreme ku janë paraqitur vështirësi ngase hapësirat e caktuara për DHPGJS janë të pamjaftueshme për akomodim të stafit dhe lëndëve. Kështu i propozohet KGJK-ës që të ketë në vëmendje problemin me hapësirat punuese për nevojat e gjykatës.

Më datën 16 qeshor 2022, është mbajtur takimi i Gjyqtarit Mbikëqyrës me gjyqtarët e DHPGJS .

Procesverbali nga takimi i bashkangjitet këtij raporti.